



#Inclusive Albania/
#ShqipëriaGjithëpërfshirëse

Termtat e Referencës

Titulli i pozicionit:	Ekspert lokal për të ofruar sesione trajnimi dhe supervizim/mentorim për ekipin multidisiplinar të Qendrës për shërbime komunitare Shijak
Projekti:	“Shërbime Sociale të Integruara për Gjithëpërfshirjen e Fëmijëve dhe të Rinjve me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Shijak”
Vendi i angazhimit:	Shijak
Kohëzgjatja e angazhimit:	31 ditë gjatë një periudhe 17 muaj (Prill 2023 – Gusht 2024)
Lloji i Kontratës:	Kontratë Individuale
Backgroundi arsimor	Diplomë universitare dhe specializim në fushat e zhvillimit të fëmijës, shëndetit mendor apo fusha studimi të ngjashme;
Eksperiencat e punës:	Minimumi 15 vite eksperiencë profesionale në fushën e trajtimit të çështjeve të shëndetit mendor dhe zhvillimit të fëmijës, dhe eksperiencia në fushën e trajtimit të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara.
Gjuha:	Anglisht & Shqip
Afati i aplikimit:	28 Mars 2023
Koha e parashikuar e fillimit:	3 Prill 2024

Prezantimi

Titulli i projektit	“Shërbime Sociale të Integruara për Gjithëpërfshirjen e Fëmijëve dhe të Rinjve me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Shijak”
Kohëzgjatja	28 muaj (1 Qershor 2022 – 30 Shtator 2024)
Financuar nga	BE në kuadër të Programit mbështetje për Përfshirjen Sociale në Shqipëri
Nr. i kontratës	IPA/2022/433-142
Zbatuesi kryesor	Bashkia Shijak
Partnerë në zbatim	Shoqata “NdiHmoni Jetën” Fondacioni Down Syndrome Albania
Qëllimi kryesor i projektit	Projekti do të kontribuojë drejt përfshirjes sociale dhe përmirësimit të cilësisë së jetës për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në Bashkinë Shijak
Përfituesit e drejtpërdrejtë të projektit	150 fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara 300 prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara 140 profesionistë (ofruar shërbime të drejtpërdrejtë dhe profesionistë të tjerë)



Funded by
the European Union

Bashkia Shijak, në partneritet me Shoqatën “Ndhmoni Jetën” dhe Fondacionin Down Syndrome Albania dhe me mbështetjen financiare nga Bashkimi Evropian, ka filluar implementimin e Projektit “Shërbime Sociale të Integruara për Gjithëpërfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në Bashkinë Shijak”, i cili implementohet në Bashkinë Shijak.

Projekti është dizenuar tju vij në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara në Bashkinë Shijak. Impakti që projekti do të ketë në komunitetin e personave me aftësi të kufizuara të Bashkisë Shijak është **krijimi i një modeli të integruar të të gjithë shërbimeve të përkujdesit për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara në Bashkinë Shijak.**

Në kuadër të implementimit të këtij projekti, Shoqatën “Ndhmoni Jetën” në bashkëpunim me partnerët në zbatim të projektit Bashkia Shijak dhe Fondacioni Down Syndrome Albania, kërkon të kontrakttoj një ekspert lokal, të aftë për të demonstruar aftësi humane dhe teknike për të informuar, mentoruar dhe rritur kapacitetet profesionale në punën me fëmijët me AK për ekipin e specialistëve të Qendrës Komunitare për personat me aftësi të kufizuara Shijak dhe stafit të programit të shërbimit lëvizës në familje, të targetuara nga ky projekt.

Qëllimi i shërbimit:

Eksperti lokal do të angazhohet:

1. Në ofrimin e sesioneve të trajnimit për ekipin e specialistëve të Qendrës Komunitare për personat me aftësi të kufizuara Shijak sipas moduleve të përgatitura nga Shoqata “Ndhmoni Jetën” për të rritur kapacitetet e tyre akademike dhe praktike në drejtim të njohurive mbi përmbajtjen e dosjes së fëmijës, përbërja e ekipit multidisiplinar; zhvillimin e hershëm të fëmijës me AK dhe çrregullime të spektrit autik; vlerësimin dhe hartimin e PEI për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale dhe çrregullime të spektrit autik, si dhe çështje të tjera të rëndësishme për zhvillimin e fëmijës dhe metodat e trajtimit të tyre në një Qendër shërbimesh komunitare.
2. Ofrimin e seancave të mentorimit/supervizimit të stafit mbi asistencën teknike dhe orientimin praktik për fushat që do të trajtohen gjatë ciklit të trajnimeve përgjatë punës me fëmijët e Qendrës Komunitare për fëmijët dhe të rinjtë me AK Shijak dhe shërbimin lëvizës.

Metodologjia

1. Programi i trajnimit përbëhet nga 11 Module trajnimi (3 module x 2 sesione; 8 module x 1 sesion). Sesionet e trajnimit do të ofrohen bazuar në metodën me pjesëmarrje ku trajneri do të prezantoj informacionin teorik të përgatitur në secilin nga modulet më sipër të ndërthurur ushtrime praktike për të përforcuar elementët që do tju prezantohen gjatë sesioneve. Pjesëmarrësit do të ftohen të bëhen pjesë aktive e seancave të trajnimit duke e konkretizuar me eksperiencat e tyre praktike, qasje e cila bën të mundur asimilimin e informacionit teorik me atë praktikë.
2. Seancat e mentorimit/supervizimit përbëhen nga 15 ditë dhe do të jenë të organizuara në formën e asistencës teknike “on-the-job training” ku specialistët do të mentorohen dhe orientohen në praktikë për të implementuar të gjitha njohuritë e trajtuara në ciklin e trajnimeve.

Përgjegjësitë e ekspertit

Nën supervizimin direkt të Manaxheres teknike për rritjen e kapaciteteve të stafeve, si dhe Manaxheres së Projektit, Eksperti pritet të:

- Ofroj sesionet e trajnimit të stafit të Qendrës Komunitare për personat me aftësi të kufizuara Shijak, sipas Manualit të trajnimeve të bërë i mundur nga organizata.
- Ofroj trajnimet sipas kalendarit të trajnimeve të përcaktuara nga Ekipi i Projektit;
- Të përgatis axhendën dhe materialet e tjera ndihmëse për trajnimin dhe seancat e supervizimit duke u kujdesur që të jenë sa më gjithëpërfshirëse;
- Të përgatis vlerësimet e para/pas trajnimit për pjesëmarrësit e përfshirë në trajnim sipas formatit të mundësuar nga Ndhmoni Jetën;

- Të ofroj senancat e mentorimit për stafin e Qendrës Komunitare në mënyrë të përmuajshme, sipas grafikut të përcaktuar nga ekipi i projektit deri në fund të zbatimit të projektit;
- Të këshillohet me Ndhmoni Jetën në avancë për çdo ndryshim në metodologjinë e trajnimit të dakortësuar paraprakisht;
- Të përgatis një raport final në fund të sesionit të trajnimit ku të përfshihen feedback i pjesëmarrësve.
- Të përgatis një raport për çdo seance supervizimi/mentorimi.

Konsulenti do të duhet të angazhohet:

- 14 sesione trajnimi;
- 2 ditë për përgatitjen e materialeve të trajnimit dhe raportimi;
- 15 ditë supervizimi/mentorimi.

Çfarë pritet nga eksperti:

Eksperti është përgjegjës të dorëzoj:

- Materialet e prezantimit për 11 temat e trajnimit, axhendën, dhe formatet e vlerësimit para-pas trajnimit – 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
- Realizoj trajnimin e stafit – bazuar në kalendarin e trajnimeve të përgatitur nga stafi i projektit.
- Raportin e trajnimeve – 10 ditë pas përfundimit të trajnimeve.
- Një program orientues për fushat që do të trajtojnë seancat e supervizim/mentorimit.
- Raportin e seancave të supervizimit/monitorimit pas çdo seance të realizuar.

Supervizimi:

Eksperti do të punoj ngushtë me Manaxheren teknike për rritjen e kapaciteteve të stafeve, dhe do të raportoj tek Manaxhere e Projektit.

Përgjegjësitë e “Ndhmoni Jetën”

- Të përgatis kalendarin e trajnimeve me datat specifike.
- Të lehtësoj procesin e organizimit të trajnimeve, vendin e trajnimit, materialet ndihmëse, dhe çështje të tjera logjistike.
- Të lehtësoj procesin e organizimit të seancave të supervizim/mentorimit, materialet ndihmëse, dhe çështje të tjera logjistike.
- Të kujdeset për logjistikën duke mundësuar fee për transportin e ekspertit në trajnim.

Politikat e mbrojtjes së fëmijëve të Ndhmoni Jetën:

- Personat që do të punojnë me Kontrata Shërbimi për Ndhmoni Jetën duhet të pranojnë me shkrim se ata kanë kuptuar “Politikën e Ndhmoni Jetën për Mbrojtjen e Fëmijëve” pjesë integrale e Manualit të procedurave të brendshme të organizatës për shërbimet për fëmijët me AK dhe standartet që përcakton kjo politike.

Vendi i konsulencës: Qendra komunitare për personat me aftësi të kufizuara, Shijak.

Kohëzgjatja e konsulencës: 3 Prill – 30 Gusht 2024.

Aftësitë e kërkuara dhe eksperiencia:

- Të zotëroj një diplomë universiteti në fushën e zhvillimit të fëmijës (Psikiatër zhvillimi, Psikologji)
- Të ketë minimum 15 vite eksperiencë profesionale në fushën e shërbime sociale për fëmijë dhe të rinjë me aftësi të kufizuara;
- Eksperiencia të mëparshme të ngjashme në ofrimin e trajnimeve dhe mentorimit për ekip multidisiplinar në Qendra komunitare për fëmijë dhe të rinjë me Aftësi të Kufizuara;

- Aftësi të dëshmuara për ekspertizën teknike dhe të dhëna të dëshmuara të përgatitjes së manualeve, moduleve të trajnimit për specialist në fushën e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, në një gjuhë praktike dhe të kuptueshme.

Procesi i vlerësimit

Ndihmoni Jetën, zotohet se do të zbatoj një proces të drejtë dhe transparent përzgjedhjeje që do të konsideroj si kualifikimin teknik të konsulentëve Individualë ashtu edhe propozimet e tyre financiare. Kontrata do t'i jepet kandidatit, oferta e të cilit Eksperti duhet të përmbushi kërkesat si më poshtë:

- Konsiderohet teknikisht e përgjegjshme / në përputhje / e pranueshme me kriteret e vendosura më lart (vetëm aplikacionet / kandidatët teknikisht të përgjegjshëm do të merren parasysh për vlerësimin financiar)
- Dhe ka marrë rezultatet më të larta të kombinuara teknike dhe financiare.

Kriteret Teknike - 70% e vlerësimit total - pikë maksimale: 70

Kriteri A: 15 vjet përvojë pune të vazhdueshme në institucionet që trajtojnë çështjet e zhvillimit psikologjik apo shëndet mendor – pikë maksimale: 25

Kriteri B: Përvoja thelbësore në trajtimin dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara - pikë maksimale: 20

Kriteri C: Aftësitë e ofrimit/lehtësimit të aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve dhe përvoja me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare – pikë maksimale: 10

Kriteri D: Përputhshmëria e formimit akademik – pikët maksimale: 15

Kriteret Financiare - 30% e vlerësimit total – pikë maksimale: 30

Kandidatët që kanë marrë një minimum prej 70% (49 pikë) të pikëve maksimale të arritshme për kriteret teknike (70 pikë) do të konsiderohen për vlerësimin financiar.

Kandidatët e interesuar duhet të dorrëzojnë:

- **Letër motivimi** - që shpjegon motivimin tuaj për të aplikuar për këtë pozicion dhe se si ju i plotësoni kriteret.
- **CV e detajuar** - me eksperiencat e mëparshme të manualeve të hartuar, studime të publikuara, etj (në rastet që është e mundur jepni link).
- **Ofertën financiare në EUR**- duke specifikuar koston totale në EUR për detyrat e specifikuar në këto Terma reference.

Planifikimi i pagesës

Shërbimi i ofruar nga eksperti do të rimbursohet në momentin që eksperti ka dorrëzuar në kohë dokumentacionet e rëna dakort për realizimin e kësaj konsulence në fund të kontratës.

Aplikimet tuaja mund ti dërgoni brenda datës 28 Mars 2023 në këtë adresë e-mailit: info@helphelife.org.al me subjekt «Aplikim për Ekspert lokal për të ofruar sesione trajnime trajnime për ekipin multidisiplinar të Qendrës për shërbime komunitare Shijak», ose në adresën postare: «Shoqata Ndihmoni Jetën, Fshati Prush, Njësia Administrative Vaqarr, Tiranë, Shqipëri.